

Dega Biznes

1. Vizatim Teknik / Autocad 10

Lënda e Vizatimit Teknik dhe AutoCAD-it jepet me metodat më sociale të përfytyrimit të formave të sendeve apo objekteve të ndryshme të natyrës. Vizatimi bëhet me ose pa vegla të vizatimit teknik, me dorë të lirë në formën e skicës, e cila shërben për bërjen e shpejtë të paraqitjes grafike të sendit apo objektit natyror. Nëse bëhet me vegla, ajo mer formën e vizatimit të punës. Në të dyja rastet, kemi të bëjmë me paraqitjen e objekteve të ndryshëm me përmasat e dhëna të gatshme për tu prodhuar ose e anasjellta, kur vizatimi është i bërë, nxënësi të jetë në gjendje ta lexojnë atë, për të krijuar idenë dhe përfytyrimin rreth objektit të paraqitur. Në AutoCAD nxënësit mësojnë kryesisht se si bëhet e mundur realizimi i vizatimit të objekteve të ndryshëm natyror nëpërmjet kompjuterit në 2D (në plan) dhe 3D (në hapësirë). Këto realizohen nëpërmjet mësimit të komandave kryesore të AutoCAD-it si dhe përfytyrimit të objekteve në hapësirë. Këto mbështeten tek praktika ku vazhdimisht bëhen ushtrime të ndryshme nga më të thjeshtat deri tek më të vështirat si nga pamjet deri tek vizatimet përmbledhëse etj.

2. Hyrje në Biznes 10

Nëpërmjet kësaj lëndë nxënësit pajisen me njohuritë kryesore në fushën e biznesit duke filluar me rolet ekonomike që luan çdo individ në jetën e përditshme (roli si konsumator, si punonjës dhe si qytetar për krijimin e të mirës së përgjithshme). Në këtë lëndë trajtohen gjithashtu rrugët më të efektshme për administrimin e të ardhurave dhe kursimeve me rrezik sa më të ulët dhe fitim sa më të lartë, mbrojtje me anë të sigurimit kundrejt humbjeve ekonomike, si vepron ky sigurim dhe pse ai është i nevojshëm.

Nxenesit marrin njohuri për zhvillimin e tregtisë së jashtme dhe asaj të brendshme funksionet e bankave, inflacionin, deflacionin, rolin ekonomik të shtetit dhe funksionet e tij

3. TIK-Aplikim ne komp(Access /Quick Books/Financa5) 12, 13 :

Program Kompjuteri ACCESS 12

Nëpërmjet kësaj lënde synohet që nxënësit të ndërtojnë Database të ndryshme në një program, të hedhin të dhenat në database, të përpunojnë informacionin dhe të nxjerrin informacionin e duhur sipas kushteve të përcaktuara më parë. Nxënësit aftësohen në njohjen e terminologjisë së programit dhe përdorimin e Printing Options.

Quick Books 12

Kjo lëndë i njeh nxënësit me programin Quick Books, një program kontabiliteti i rëndësishëm për mbajtjen e evidencës kontabël dhe shumë i lehtë për tu përdorur. Lënda nëpërmjet orëve teorike, praktike dhe laboratorike do t'i njohë nxënësit me llojin e informacionit që nevojitet në një biznes dhe me mënyrën se si ky informacion mund të futet dhe të ruhet në një Quick Books. Përdorimi i Quick Books u mundëson nxënësve të aftësohen në krijimin e një biznesi, në regjistrimin e veprimeve të biznesit, nxjerrjen e raporteve si dhe paraqitjen grafike të tyre dhe analizën ekonomiko-financiare të biznesit.

Zbatim Kompjuteri

Program Kompjuteri (Financa 5) 13

Programi i kompjuterit përfshin njohuri të softeve të avancuara të nivelit profesional Financa 5. Nxënësit marrin njohuri në këtë fushë duke qenë të lidhur ngushtë me lëndën e tyre profesionale, sidomos me lëndën e kontabilitetit. Është program i avancuar, nëpërmjet të cilit administrohen llogaritë e ndryshme financiare si dhe ndërtohen bilance të të gjitha llojeve dhe deklaratave për një biznes tregtar. Qëllimi i kësaj lënde është që nxënësit të mësojnë programet bashkëkohore që gjejnë përdorim të gjerë sot në çdo sektor të ekonomisë.

4. Praktikë Zyre 11

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit përgatiten me njohuritë e domosdoshme për të punuar në zyra. Kjo lëndë i pajisë ata me informacion të ditëve të sotme: njohuritë bazë të komunikimit, marrje vendimesh, zgjidhje të problemeve të ndryshme, menaxhim të stresit në punë, me vendin e punonjësit në zyrë dhe lidhjet e tij me mjedisin ku punon. Këtu mësohen procedurat e punësimit, organizimi i punës, përgatitja e dokumentave të biznesit, mënyra e mbajtjes së dokumentave duke theksuar faktin që sukcesi i punës varet nga krijimi i marrëdhënieve ndërpersonale të mira. Mëson si të përdorë teknikat e komunikimit verbal dhe jo verbal.

Gjithashtu synohet të krijohet një ide e qartë për marrëdhëniet në grupin e punës, marrëdhëniet me eprorin, mënyra e dhënies së prioriteteve në punë për t'u krijuar satisfaksione drejtuesve dhe mundësi që krijohen në favor të punonjësve.

5. Kontabilitet 11,12,13:

Kontabilitet 11

Nëpërmjet kësaj lënde synohet që nxënësi të marrë njohuritë e nevojshme për kontabilitetin, njohjen me terminologjinë e tij e cila lidhet me karrierën e kontabilistit, të dijë njohuritë e nevojshme për karrierë në fushën e kontabilitetit e lidhur ngushtë kjo me aftësinë për të komunikuar. Gjithashtu kjo lëndë trajton ekuacionin kontabel, njohjen e terminologjisë për asetet, borxhet dhe kapitalin, mbajtjen e evidencës kontabel në biznese shërbimi dhe tregtare të organizuara si vetëpronësi dhe bashkëpronësi. Nxënësi merr njohuri mbi sistemin e pagave, taksat mbi pagat të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarresit ndaj shtetit bazuar në ligjet mbi pagat si dhe kontabilizimin e pagave.

Kontabilitet 12

Lënda zhvillohet në klasën e 12-të dhe është vazhdim i njohurive të marra në klasën e 11-të. Programi ruan të njëjtën linjë duke pajisur nxënësit me njohuri praktike dhe teorike kryesisht në kryerjen e një cikli kontabiliteti për forma të reja të biznesit që nuk janë trajtuar në klasën e 12-të si: Bashkëpronësi dhe Korporatë. Nxënësit marrin njohuri: për formimin, shpërbërjen dhe likuidimin e organizmave të

biznesit, për blerjen e aktive të qëndrueshme dhe metodat e llogaritjes të amortizimit, për inventarin, llojet e inventarëve dhe metodat e llogaritjes së inventarit. Gjithashtu nxenesit mesojne se si te regjistrojne ne kontabilitet importet,eksportet blerjet dhe shitjet online. Kontabiliteti i klasës 12-të u jep mundësi nxënësve të punojnë nesër si specialistë në këtë fushë.

Kontabilitet 13

Kjo lëndë synon që nxënësi të njihet me shoqëritë aksionere, kapitalin aksioner dhe përbërjen e këtij kapitali dhe me hartimin e deklaratave financiare për shoqëritë aksionere. Nxënësit njihen me buxhetin, planifikimin e tij, faktorët që ndikojnë në marrjen e vendimeve, bëjnë analiza financiare të treguesve afatgjatë dhe afatshkurtër në ecurinë e punës dhe në marrjen e vendimeve në shoqëritë aksionere. Ata njohin kompanitë prodhuese dhe kontabilizojnë transaksionet deri në nxjerjen e produktit të gatshëm, njihen dhe me organizatat jofitimprurëse dhe realizojnë një cikël të tërë të kontabilitetit për OJF-të (organizatat jofitimprurëse). Ne mbarim te kontabilitetit 13 nxenesit aftesohen si Bookkeepers (llogaritare) dhe mund te punesohen ne cdo zyre kontabiliteti.

6. *Menaxhim 13*

Synimi i kësaj lënde është marja e njohurive kryesore për menaxhimin duke u fokusuar në njohuritë dhe aftesitë kryesore të një menaxheri të suksesshëm. Kjo lëndë trajton me detaje pesë funksionet kryesore të menaxhimit që janë: planifikimi, drejtimi, zbatimi, stafi dhe kontrolli menaxherial. Gjithashtu nxënësit njihen me mënyrat e marrjes së vendimeve dhe strategjitë e ndryshme menaxheriale që përdoren për ecurinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të firmave të ndryshme. Pasi nxënësit kanë marrë njohuri teorike, zhvillojnë raste studimore të ndryshme ku zbatojnë njohuritë e fituara. Gjithashtu janë të aftë të analizojnë situata të menaxhimit të kompanive.

7. *Ekonomiks 11, 12:*

Ekonomiks 11

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësi pajiset me njohuritë kryesore të teorive mikroekonomike dhe makroekonomike. Ky program trajton edhe koncepte si: kërkesa, oferta, elasticiteti, ekuilibri i tregut, faktorët e tij, produktin e brendshëm të përgjithshëm, inflacioni, papunësia, politika fiskale, politika monetare, funksionet kryesore të bankave të nivelit të parë dhe të dytë. Nxënësit ushtrohen në paraqitjen grafike të koncepteve ekonomike, llogaritjen e pasqyrimin grafikë të ndikimit të koncepteve ekonomike dhe llogaritjen e pasqyrimin grafikë të ndikimit të faktorëve të ndryshëm në modele të ndryshme tregu. Analizon tregun në varesi të kushteve dhe faktorëve që ndikojnë në të.

Ekonomiks 12

Në klasën e 12-të trajtohen problemet makroekonomike të ekonomisë të një vendi. Kjo pjesë e ekonomisë përfshin: treguesit e inflacionit, tipet e inflacionit, tregues të papunësisë si dhe shkaqet për të cilat nxënësi arrin të identifikojë tipet e papunësisë, politikën fiskale, politikën monetare, modele të ndryshme ekonomike parë këto nga studjues të njohur në fushën ekonomike, bankat, marrëdhëniet ndërkombëtare, politikat dhe luhatjet makroekonomike. Të gjitha këto njohuri aftësojnë nxënësit të jenë zgjedhës të mirë në fushën e problemeve ekonomike. Ata arrijnë të krahasojnë, të vlerësojnë situatat ekonomike dhe influencat e faktorëve makroekonomike në një treg kombëtar.

8. *Marketing 13*

Kjo lëndë trajton njohuritë bazë të marketingut duke dhënë principet bazë për çështje të rëndësishme. Në këtë lëndë përfshihen: kuptimi i marketingut dhe filozofitë e tij, planifikimi i marketingut, strategjitë e marketingut që duhet të ndjekin firmat, analizimi i mundësive të marketingut, zhvillimi i marketingut, seleksionimi i tregjeve, katër elementet e marketingut mik (produkti, çmimi, promovimi, shpërndarja), cikli i jetës së produktit, shitjet me shumicë dhe pakicë. Lënda e marketingut është e pajisur me libra bashkohorë dhe të pasur me shembuj duke i ndihmuar nxënësit në përvetësimin e plotë të lëndës, në zbatimin e teorive dhe në praktikën mësimore. Nxënësit marrin njohuri dhe për zhvillime të reja në fushën e marketingut, marketingu dixhital që realizohet nëpërmjet teknologjisë dhe rrjeteve sociale.

9. *Financë 12,13:*

Financë 12

Nëpërmjet lëndës së financës nxënësi merr konceptet kryesore dhe me të rëndësishme të financës si: sistemet financiare, tregjet financiare dhe ndërmjetësit financiare. Nxënësi duhet të njihet me funksionet e pasqyrave financiare dhe të jetë në gjendje ti interpretojë ato. Ai do të marrë njohuri mbi koncepte të rëndësishme të drejtimit të financës së një firme, kosto e kapitalit, strukturë kapitali, parimet e vlerësimit të aktiveve, riskun dhe drejtimin e tij dhe do të jetë në gjendje të bëjë vlesësimin e letrave me vlerë, aksion, obligacion.

Financa 13

Kjo lëndë synon njohjen e nxënësve me burimet e fondeve me afat të shkurtër si : huatë me këste, huatë e hipotekës dhe kredia tregtare etj. Ajo gjithashtu synon njohjen koston së kapitalit psh: koston e aksioneve të preferuar dhe të zakonshëm, buxhetimin e kapitalit (psh: vlerën aktuale neto apo normën e brendshme të fitimit), objektin e financave publike, të ardhurat publike, shpenzimet publike, klasifikimin e tatimeve, taksave, doganave dhe huave publike si dhe parimet e tyre. Gjithashtu synon hartimin e buxhetit të shtetit si dhe zbatimin e tij në vendin tonë. Ne kete lende nxenesi merr njohuri per te gjitha ndryshimet ne legjislacionin shqiptar ne lidhje me tatimet e taksat ne vendin tone.

10. *Statistike – Ligj 13*

Statistikë 13

Synimi i lëndës është trajtimi i çështjeve që kanë lidhje me përdorimin e të dhënave dhe metodave statistikore në biznesin bashkëkohor. Kjo lëndë përfshin studimin e të dhënave të grupuara dhe të pagrupuara si dhe paraqitjen grafike të tyre. Ne kete lende nxenesit marrin njohuri per llogaritjen e treguesve te tjere si moda, mediana, devijacionin absolut, standart

shpërndarjet diskrete dhe të vazhdueshme. Kjo lëndë i ndihmon nxenesit në përdorimin e metodave statistikore dhe në lendet e tjera si Praktike, Finance, Kontabilitet, Marketing. Në kete lende nxenesit bejne studime startistikore analizojne dhe interpretojne treguesit statistikore.

E drejta dhe legjislacioni 13

Në këtë lëndë nxënësit marrin njohuri kryesore për të drejtën në përgjithësi dhe detyrimet e kontratat, si një nga pjesët më kryesore për aktivitetet tregtare. Nxënësit mësojnë elementë të zotësisë juridike dhe zotësisë për të vepruar, mësojnë elementë të rëndësishëm si përbërësit e organeve drejtuese legjislative të një shteti. Ata studiojnë marrëdhëniet juridike civile, detyrimet, tipe të ndryshme kontratash, llojet e shoqërive, krijimi dhe likuidimi i tyre. Kjo lëndë shton dhe përmirëson bagazhin e tyre kulturor në fushën ekonomike.

11. *JA Etike biznesi, Shoq. e nxenesve + (Z.Detyruar) 11, 12:*

Etikë Biznesi (Junior Achievement) 11

Programet e "JA" për shkollat e mesme janë zhvilluar duke vënë theksin parësor tek përmbajtja e studimeve sociale, lexim, shkrim dhe aftësitë. Nxënësit mësojnë konceptet themelore të biznesit dhe ato ekonomike, eksplorojnë interesat dhe mundësitë për karrierë dhe mësojnë parimet e rëndësishme të gadishmërisë në punë duke gërshetuar teorinë me praktikën.

Shoqëritë e nxënësve (Junior Achievement) 12

Lënda Shoqëritë e nxënësve mbështetet në 3 modele: a) Shoqëritë e nxënësve; b) Drejtues për një ditë; c) Aftësitë Sipërmarrëse. Qëllimi kryesor është aftësimi i nxënësve në hapjen e një shoqërie aksionere, zhvillimi i ideve për një produkt inovator, realizimi i produktit, shitja dhe blerja, regjistrimi i dokumentave financiare dhe nxjerrja e rezultateve. Nxënësit nëpërmjet "Drejtues për një ditë" duhet të jetojnë eksperiencën e menaxhimit të një biznesi. Lënda është mjaft tërheqëse dhe praktike.

12. Praktikë Profesionale 12, 13:

Praktikë Mësimore 12

Nëpërmjet kësaj lëndë synohet që nxënësi të interpretojë në mënyrë konkrete njohuritë e marra në lëndë të ndryshme teorike të specialitetit dhe t'i zbatojë dhe demonstrojë ato në biznesin e krijuar në sallën e praktikës-zyra mësimore. Qëllimet e kësaj lënde janë: përcaktimi i fushës së aktivitetit, krijimi i planit të biznesit, sektoret, funksionimi i sektorit të blerjeve dhe shitjeve dhe sektoreve të tjera, magazina, maredheniet me klientet dhe furnitorët dokumentacioni përkatës, pagat, mbajtja e evidencës kontabel për realizimi i një cikli kontabiliteti dhe nxjerja e rezultatit të biznesit. Kjo lëndë ben lidhje të punës në sallën e praktikave me punën në bizneset reale nëpërmjet vizitave që organizohen nga shkolla dhe mesuesit e praktikave, kjo ju jep mundësinë nxënësve që në të ardhmen të punojnë në vende pune që kërkojnë individë të kualifikuar në specialitetin e biznesit. Praktika zhvillohet në një ambient të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme dhe bashkohore si kompjuter, video-projector, flip-chart ku nxënësit punojnë dhe prezantojnë realizimin e objektivave të kësaj lënde.

Praktikë mësimore 13

Kjo lëndë synon që nxënësi të njohë procedurat juridike të krijimit të një ndërmarjeje, të njohë parimet e organizimit dhe zhvillimit të ciklit të kontabilitetit, të njohë metodat e studimit të tregut, paraqitjen dhe përpunimin e të dhënave si dhe interpretimin e tyre. Nxënësi prezanton aktivitete reklame duke përdorur marketingun dixhital si newsletters, website etj. Nëpërmjet këtij programi ai do të njohë procedurat e punësimit dhe llogaritjen e pagës së tyre (të jenë në gjendje të njohin aftësitë e tyre në përzgjedhjen e karrierës), të hartojë një plan prodhimi, të përcaktojë pragun e prodhimit me ndihmën e analizës Break-Point dhe të realizojë nxjerjen e kostos së produktit të gatshëm.